

Tryezë pune mbi bashkëpunimin ndërinstitucional për forcimin e ligjshmërisë dhe transparencës në funksionimin e Këshillave Bashkiake

Në kuadër të Projektit Bashki të Forta, financuar nga SDC - Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Qeveria e Suedisë, zbatuar nga Helvetas, Ervis Shimaj Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau i Dejës dhe Ardian Celepija Sekretari i Këshillit Bashkiak morën pjesë në një tryeze pune ndërmjet Këshillave Bashkiake të Qarkut Shkodër dhe Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e qartësisë institucionale ndërmjet tyre. Në këtë tryezë u diskutua një raport vlerësimi i situatës, hartuar nga IDM në qershor 2025 për 6 këshilla bashkiakë (Shijak, Shkodër, Lezhë, Mirditë, Dibër, Kukës), ku janë evidentuar problematika të ndryshme në kategorizimin dhe trajtimin e akteve normative dhe individuale, si dhe në cilësinë e dokumentacionit shoqërues që përcillet për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiakë.

Në këtë kontekst u diskutua mbi rolin e institucioneve mbështetur në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse dhe mbi çështje të përmirësimit të përmbajtjes së relacioneve dhe dokumentacionit shoqërues të vendimeve.

